

# Raport krahasimor lidhur me konstatimet dhe rekomandimet e Raportit për Vendlin në Qeverisje të Mirë dhe Sundim të Rendit dhe Ligjit për vitet 2021 dhe 2022

## Qeveria



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde

Rockefeller  
Brothers Fund  
Philanthropy for an Interdependent World

Instituti i Kosovës për Drejtësi në kuadër të Programit- “Qeverisje e Mirë” ka bërë analizimin e raporteve të vendit të Komisionit Evropian për Kosovën për vitet 2021 dhe 2022. Ky vlerësim është bërë me qëllim të matjes së progresit nga institucionet kyçe në përmirësimin e fushave që ndërlidhen me sundimin e ligjit dhe qeverisjes së mirë.

Raporti i vendit për vitin 2022, karakterizohet me progres të kufizuar në disa fusha të caktuara, vazhdim i gjendjes së njëjtë në shumë fusha të tjera, si dhe pritje më të larta për institucionet dhe si rrjedhojë edhe rritje të numrit të rekomandimeve që duhet të zbatohen gjatë vitit 2022 dhe 2023 nga institucionet. Ngjashëm, ky raport ka identifikuar edhe ngecje apo regres në fusha të caktuara.

## ZGJEDHJET

Për vitin 2022, në parim Komisioni Evropian vlerëson lartë proceset e organizimit të zgjedhjeve (qendrore dhe ato lokale të organizuara gjatë vitit 2021), por po ashtu ka gjetur të meta në proceset e këtyre zgjedhjeve. E metë specifike është kandidimi dhe pjesëmarrja e ulët e grave për kryetar të komunave, trajtimi i ankesave dhe procedurat e stërzgjatura, dhe problemet në pjesën veriore të Kosovës ku në masë të madhe është e dominuar nga Lisat Serbe, ku konkurrenca politike ka qenë e kufizuar.

### 2021

- 1 Dobësi në numërimin e votave, procesin e votimit jashtë Kosovës dhe trajtimin e ankesave
- 2 Koncentrim i aktiviteteve politike për fushatë vetëm tek partia Lista Srpska.

### 2022

- 1 Procesi i zgjedhjeve i stërzgjatur dhe i dëmtuar nga dobësi të konsiderueshme.
- 2 Numër i ulët i kandidateve gra për kryetarë të komunave

## Rekomandime:

- Adresimi i të metave të evidentuara nga Monitoruesit e Bashkimit Evropian në zgjedhjet e vitit 2014, me theks të veçantë në vendosjen e mekanizmave mbrojtës të procesit të zgjedhjeve nga ndikimi politik.
- Kosova duhet të rishikojë legjislacionin për organizimin dhe mirëmbajtjen e zgjedhjeve si në nivel lokal e ashtu edhe atë të përgjithshëm.

# Kuvendi

Në parim si në vitin 2021 e ashtu edhe në 2022 të gjeturat e Kuvendit janë pothuajse të njëjta. Edhe këtë vit raporti evidenton se legjislatura e tetë vazhdon të jetë e ndikuar në mënyrë negative, nga një atmosferë politike e polarizuar dhe me mungesë të kuorunit vendimmarrës, pavarësisht faktit se partia në pushtet ka një shumicë solide me 67 deputet. Legjislatura e kaluar nuk e ka pasur këtë komoditet, por si në legjislaturën e kaluar ashtu edhe në të tashmen Parlamenti ballafaqohet me mungesë të kuorunit, pa mbikëqyrje të mirëfilltë të ekzekutivit, votim me duar (jo elektorinik), etj. Sipas raportit të progresit, Kuvendi rriti përdorimin e procedurave të përshpejtuara të miratimit të legjislacionit kyq. Pak parti politike e tejkaluan kuotën gjinore prej 30%, dhe për këtë arsye nuk e kaluan përmbushjen e objektivit prej 50% për përfaqësim të barabartë në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore.

## 2021

- 1 | Atmosferë e polarizuar politike
- 2 | Mungesë e shumicës efektive të mazhorancës
- 3 | Mungesë e kuorunit
- 4 | Mbikëqyrja parlamentare ndaj ekzekutivit si dhe e institucioneve të tjera vazhdon të mbetet e dobët
- 5 | Financimi dhe shpenzimet e partive politike dhe fushatave elektorale mbeten jotransparente dhe kuadri ligjor ekzistues kryesisht nuk zbatohet

## 2022

- 1 | Atmosferë e polarizuar politike
- 2 | Mungesa e kuorunit vendimmarrës pavarësisht faktit se qeveria mbështetet në një shumica prej 67 mandatesh (nga 120)
- 3 | Abstenim nga votimi i opozitës
- 4 | Kuvendi jo efektiv në mbikëqyrje parlamentare
- 5 | Për shkak të zgjedhjeve lokale në vjeshtë të vitit 2021, puna e Kuvendit u ngadalësua nga deputetët që u angazhuan në zgjedhje lokale
- 6 | Kuvendi nuk ka plan vjetor të punës
- 7 | Miratim i ligjeve kyçe me procedurë të përshpejtuar
- 8 | Menaxhim i dobët i agjendës legjislative
- 9 | Kuvendi nuk ka zbatuar procesin e votimit elektronik, gjë që ka çuar në shumë raste rezultate të pasakta të votimit
- 10 | Kuvendi nuk i publikon të dhënat e votimit të deputetëve, gjë që cenon transparencën dhe llogaridhënien ndaj publikut

## Rekomandimet

Shumica dhe opozita duhet të përmirësojnë dialogun politik dhe të punojnë së bashku për të avancuar më tej agjendën e reformave të BE-së dhe për të krijuar konsensus rreth reformave të mëdha

Kuvendi duhet të përmirësojë menaxhimin e tij të brendshëm, të miratojë një plan vjetor të punës, të kalojë me shpejtësi nga sistemi i ngritjes së dorës në votim elektronik dhe të forcojë funksionin e tij mbikëqyrës

Kuvendi duhet të mbështesë punën e rregullatorëve dhe institucioneve të pavarura në mënyrë më sistematike, duke bërë emërimin e anëtarëve të bordeve të tyre në kohën e duhur dhe sigurimin e monitorimit të rregullt të zbatimit të rekomandimeve të ofruara nga Komisionet

Kuvendi duhet të ushtrojë të gjitha mjetet në dispozicion për të mbajtur qeverinë dhe institucionet e tjera të japin llogari para tij



# Shoqëria civile

Sipas raportit të progresit, në përgjithësi shoqëria civile në Kosovë vazhdon të operoj në një ambient relaksues. Organizatat e shoqërisë civile janë në përgjithësi të lira të ushtrorjnë të drejtën e tyre për asoçim, dhe ti shprehin qendrimet e tyre kritike pa presion nga autoritetet publike duke përfshi ato në promovimin e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore.

Bashkëpunimi me qeverinë ka nevojë për përmirësim të mëtutjeshëm përmes një niveli më të lartë të transparencës dhe angazhimit. Progres i kufizuar është arritur në zbatimin e strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023. Këshilli për bashkëpunim të qeverisë me shoqërinë civile është takuar vetëm një herë gjatë vitit 2021. Puna e Këshillit duhet të jetë më efektive dhe e qasshme, përfshirë kërkesën për publikimin e aktiviteteve të rregullta të aktiviteteve kyçe.

## 2021

- 1 Shoqëria civile dhe qeveria duhet të vazhdojnë të përmirësojnë më tej bashkëpunimin e tyre dhe të rrisin aftësinë e shoqërisë civile për të kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e politikave publike
- 2 Ka pasur progres të kufizuar në lidhje me strategjinë e qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile për periudhën 2019-2023 dhe planin e saj të veprimit
- 3 Nuk është miratuar legjislacioni zbatues në lidhje me zbatimin e Ligjit për Lirinë e Asociimit të vitit 2019 që do të lehtësonte procesin e regjistrimit të organizatave
- 4 Raporti i fundit vjetor i qeverisë për konsultimin publik tregon se disa ministri nuk po organizojnë konsultime në përputhje me rregulloren përkatëse.

## 2022

- 1 Pjesëmarrja e publikut në procesin legjislativ është ende e kufizuar dhe kontributet e ofruara nga shoqëria civile nuk pasqyrohen sistematikisht në raportet e konsultimit publik
- 2 Është arritur progres i kufizuar me zbatimin e strategjisë për bashkëpunim me shoqërinë civile 2019-2023
- 3 Nuk ka progres në lidhje me zbatimin e Ligjit për Lirinë e Asociimit të vitit 2019 që do të lehtësonte procesin e regjistrimit të organizatave
- 4 Në nivel komunal, numri i konsultimeve online është rritur pak, por ai mbetet dukshëm më i ulët se ato të organizuara në nivel qendror nga ministrinë përkatëse
- 5 Është takuar vetëm njëherë Këshilli Qeveritar për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile

## Rekomandimet

Bashkëpunimi me qeverinë duhet të përmirësohet më tej përmes një niveli më të lartë angazhimi dhe të transparencës. Puna e Këshillit Qeveritar për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile duhet të bëhet më efektive dhe më e qasshme, duke përfshirë publikimin e rregullt të aktiviteteve kryesore.

Rregullorja për financimin publik të OJQ-ve kërkon monitorim dhe ndjekje të rregullt nga Ministria e Financave.

Mjedisi për vullnetarizmin duhet të përmirësohet, duke përfshirë vendosjen e një kuadri të përshtatshëm legjislativ, në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe shpërndarjen e burimeve financiare dhe njerëzore për programet e vullnetarizmit të rinjve.



# Reforma e administrates publike

Ndër fushat më problematike që ka shpërfaqur Raporti për vitin 2022, përfshin reformen në administratën publike, ku raporti konstaton se ka progres të mangët në zbatimin e kornizës ligjore ekzistuese të reformës së administratës publike. Ky raport, po ashtu vlerëson së është bërë një nivel i pregaditjes për këtë fushë, por ekziston progres i kufizuar në këtë drejtim.

Kosova mbetet në një nivel të pregaditjes dhe ka bërë progres të kufizuar në reformen e administratës publike (RAP). Me theks të veçantë, disa hapa pozitiv janë ndërmarr në zhvillimin e strategjisë gjithpërfshirëse për RAP dhe për menaxhimin e financave publike 2022-2026, duke mirëmbajtur dhe zbatuar strategjinë e financave publike, miratimin e ligjit për valën e parë të ri-organizimit të agjencive dhe duke inicuar zhvillimin e projekt ligjit për Pagat i cili duhet të finalizohet dhe miratohet. Përderisa korniza ligjore është pjesërisht i miratuar, mungon progresi në zbatim.

Vonesat në zbatimin e ligjit për Zyrtarët Publik ka cenuar rekurritmin e centralizuar dhe atë organizativ. Finalizimi i klasifikimit të vendeve të punës dhe sistematizimi i pozitave ka qenë i ngadalshëm dhe ka krijuar mospërputhje të konsiderueshme në kapacitetet administrative. Zbatimi i pamjaftueshëm i ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura ka dërguar deri tek një nivel të paknaqshëm të përmirësimit të performancës dhe llogaridhënies në administratën publike.

Pas vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2019, ndryshimet në proces të ligjit për zyrtaret publik duhet të harmonizohen me parimet e RAP para miratimit.

## Korniza strategjike e administratës publike

### 2021

- 1 | Progresi i zbatimit të reformave është ngadalësuar për shkak të situatës politike
- 2 | Nuk ka pasur veprime pasuese në sistemin e reformuar të monitorimit të strategjive.

### 2022

- 1 | Përkrahje e mangët politike për procesin e RAP
- 2 | Monitorimi i reformave të RAP nuk është sistematik
- 3 | Kapacitete të limituara të MPB në udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e RAP



## Zhvillimi i politikave dhe koordinimi

### 2021

- 1** Ekziston nevoja për një rol më të fortë të qendrës së qeverisë në sigurimin e kontrollit të cilësisë së vlerësimeve të ndikimit rregullator dhe buxhetor
- 2** Konsultimet publike nuk janë sistematike
- 3** Mangësi në zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, si dhe caktimi i pikave të kontaktit të dhënave brenda administratës

### 2022

- 1** Përparim i kufizuar në forcimin e mëtejshëm të politikave dhe zhvillimit legjislativ gjithëpërfshirës dhe të bazuar në fakte
- 2** Konsultimet publike të projekt ligjeve organizohen shumë vonë në proces
- 3** Komentet e Shoqërisë Civile për politika nuk reflektohen në mënyrë sistematike
- 4** Buxhetimi dhe planifikimi i politikave jo mirë të integruara

## Rekomandime specifike të fushës në vitin 2022:

Kapacitetet e Zyrës së Planifikimit Strategjik, përgjegjëse për koordinimin e përgjithshëm të planifikimit, monitorimit dhe raportimit, dhe për vlerësimet e ndikimit rregullator, duhet të forcohen më tej

Qeveria duhet të sigurojë që procesi legjislativ të jetë në përputhje me parimet dhe standardet për hartimin e legjislacionit, duke përfshirë nxjerrjen sistematike të koncept dokumenteve si bazë për reforma



## Menaxhimi i Financave Publike

### 2021

- 1 | Zbatimi i kontratave të prokurimit mbetet i prirur ndaj parregullsive dhe i cenusshëm ndaj korrupsionit

### 2022

- 1 | Strategjia e re për menaxhimin e financave publike nuk është miratuar ende
- 2 | Raportimi në zbatimin e Planit të Veprimit për 2021 është vonuar
- 3 | Raporti mbi zbatimin e buxhetit nuk është i qasshëm në portalin për transparencën fiskale

---

### Rekomandime Specifike të fushës:

MFPT duhet të përmirësojë pronësinë e strategjisë së re të MFP-së dhe ligjit të ri organik të menaxhimit të financave publike, pasi të njëjtat ndikojnë në zbatimin e Programit për Reforma në Ekonomi për 2022-2024.

---



# Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

## 2021

- 1 Shkrija e Ministrisë së Administratës Publike dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme rezultoi në reduktimin e udhëheqjes politike në reformën e administratës publike dhe ka dëmtuar efikasitetin, kapacitetin dhe proceset e punës për zbatimin e reformave të administratës publike  
Vonesat në ngritjen e strukturave të nevojshme të menaxhimit qendror për zyrtarët publikë brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe pajisja e saj me stafin dhe kapacitetet e nevojshme kanë penguar zbatimin e sistemit të ri të menaxhimit të zyrtarëve publikë
- 2 Përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në administratën qendrore, si dhe numri i grave në pozita të larta, mbetet i pamjaftueshëm
- 3 Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese ka lënë Kosovën pa legjislacion që rregullon pagat në administratë
- 4 Zbatimi i planeve të integritetit është i limituar në shërbim civil
- 5 Nuk ka menaxhim efektiv të performancës në administratë
- 6 Ndikimi politik mbi emërimet dhe shkarkimet e nëpunësve të lartë civilë mbetet një shqetësim
- 7 Vendimi për shkarkimin e këshillit mbikëqyrës të shërbimit civil e ka lënë këshillin pa kuorum

## Rekomandime specifike:

Funksionimi i Këshillit të Pavarur për Mbikëqyrjen në Shërbimin Civil duhet të sigurohet dhe të përmirësohen kapacitetet e tij për të monitoruar dhe mbikëqyrur më mirë procedurat e shërbimit civil dhe trajtimin e ankesave

Mekanizmat e sinjalizimit dhe kërkesat e mbrojtjes së sinjalizuesëve ende duhet të forcohen dhe zbatohen në mënyrë efektive

## 2022

- 1 Kapacitetet e MPB janë të mangëta për udhëheqje efektive të reformave të administratës publike
- 2 Zbatimi i LZP-së aktuale është vonuar shumë duke shkaktuar kufizime dhe boshllëqe në kapacitetet administrative në të gjithë administratën publike
- 3 Përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë në administratën qendrore, si dhe numri i grave në pozita të larta, mbetet i pamjaftueshëm
- 4 Baza ligjore për paga mbetet e fragmentuar që rezulton në sistem që nuk arrin të sigurojë parimet e transparencës, meritës dhe trajtimit të barabartë
- 5 Zbatimi i limituar i planeve të integritetit në shërbim civil
- 6 Dispozita e LZP për zhvillimin e nëpunësve civilë, duke përfshirë vlerësimin e performancës, lëvizshmërinë dhe promovimin nuk zbatohen në praktikë
- 7 Mungojnë të dhëna përkatëse për shërbimin civil në sistemin SIMBNJ
- 8 Situata në Administratë rëndohet nga mungesa e të dhënave, siç është analiza zyrtare e pagave të shërbimit civil;
- 9 Miratimi i planit të rekrutimit ende nuk është bërë
- 10 Amendamentet e Ligjit për Zyrtarë Publik (LZP) janë më të gjera se sa kërkohet në aktvendim të Gjykatës Kushtetuese dhe duhet të harmonizohen me parimet e meritës para miratimit

Reforma në shërbimin civil dhe menaxhimin e burimeve njerëzore (siç janë finalizimi i organizimit të brendshëm të Ministrive dhe klasifikimi i pozitave) duhet të bëhen paralelisht me ligjin e pagave, në mënyrë që të sigurohet një sistem i drejtë dhe transparent i pagave të barabarta për kualifikime të barabarta në shërbimin civil

# Llogaridhënia e administratës

## 2021

- 1** Zbatimi i Ligjit të ri për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura mbetet i dobët
- 2** Nuk ka pasur zhvillime tjera në zbatimin e planit të veprimit për racionalizimin e agjencive
- 3** Shumica e agjencive ende nuk i kanë harmonizuar organizimet e tyre të brendshme me kornizën ligjore
- 4** Rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Ombudspersonit nuk zbatohen në mënyrë efektive nga institucionet publike
- 5** Zbatimi i ligjit për qasje në dokumente publike është i mangët si pasojë e vonesës në emërimin e udhëheqësit të AIP
- 6** Gjykata Themelore në Prishtinë ende po përballet me një numër të madh të lëndëve administrative

### Rekomandime Specifike të fushës:

Qeveria duhet ta çojë përpara procesin e racionalizimit në mënyrë më strategjike, duke rishikuar planin e veprimit për racionalizimin e agjencive

Qeveria duhet të ngrisë një trup pune ndërqeveritar për të drejtuar dhe përmirësuar kapacitetet mbikëqyrëse për të zbatuar LOFSHAP tek ministritë e linjës

Qeveria duhet të reformojë zinxhirin e delegimit në shërbimin civil për krijimin e një sistemi në linjë me parimet e llogaridhënies

Mbikëqyrja e Kuvendit mbi qeverinë duhet të forcohet

Gjyqësori duhet të rrisë efikasitetin e tij në trajtimin e mosmarrëveshjeve administrative për të siguruar të drejtat e qytetarëve dhe qasjen në drejtësinë administrative

### Rekomandime të përgjithshme të RAP:

Të përmirësohet funksionimi i shërbimit civil duke përsheptuar zbatimin e Ligjit për Zyratë Publike në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe me parimet e Reformës së Administratës Publike, duke organizuar rekrutime të centralizuara

Të zhvillohet një skemë koherente pagash në përputhje me parimet e meritës, drejtësisë dhe trajtimit të barabartë në shërbimin civil

Qeveria duhet të finalizojë organizimin e brendshëm të ministrive duke vendosur klasifikime të vendeve të punës dhe sistemim të vendeve të punës në shërbimin civil

Të përmirësojë sigurinë ligjore dhe reduktimin e barrës administrative të administratës publike ndaj bizneseve dhe qytetarëve, duke zbatuar Programin për Parandalimin Administrativ dhe Reduktimin e Barrës dhe Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative

Të përmirësojë llogaridhënien në sektorin publik duke: (a) zbatimin efektiv të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura dhe (b) përsheptimin e riorganizimit të vazhdueshëm të agjencive duke krijuar një organ drejtues dhe duke miratuar një plan veprimi të rishikuar për racionalizim

## 2022

- 1** Ligji për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura (LOFASHAP), që mbulon performancën dhe llogaridhënien, nuk zbatohet mjaftueshëm
- 2** Procesi i racionalizimit është vonuar për shkak se rishikimi i agjencive nuk është bërë deri në fund të periudhës kalimtare të parashikuar në ligj
- 3** Rishikimi i agjencive të ristrukturuara dhe krijimi i agjencive të reja, në përputhje me standardet e LOFASHAP, mbeten të kufizuara për shkak të kapaciteteve të dobëta të Ministrisë së Punëve të Brendshme për të kontrolluar cilësinë e këtyre proceseve
- 4** Rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Ombudspersonit nuk zbatohen në mënyrë efektive nga institucionet publike
- 5** Zbatimi i ligjit për qasje në dokumente publike mbetet sfidë
- 6** Komisioneri për Informacionin dhe Privatësinë nuk ka kapacitete të mjaftueshme mbikëqyrëse për të siguruar një mekanizëm të pavarur ankimi nëse organet publike refuzojnë ose shpërfillin kërkesat
- 7** Mbikëqyrja parlamentare e punës së Qeverisë është e limituar
- 8** Linjat e llogaridhënies në administratë janë të turbullta me shumë agjenci të pavarura që ndajnë funksionet ekzekutive dhe raportojnë në Kuvend dhe shumë agjenci vartëse që raportojnë, në mënyrë joefikase, tek ministritë e linjës
- 9** Institucionet publike vazhdojnë të mos publikojnë në faqet e tyre të internetit, planet vjetore, raportet, buxhetet dhe planet financiare



# Ofrimi i shërbimeve për qytetarët dhe bizneset

## 2021

- 1** Nuk ka një politikë koherente, të drejtuar nga qendra për ofrimin e shërbimeve publike të përqendruara te përdoruesit
- 2** Progresi drejt thjeshtimit të procedurave administrative është ngadalësuar
- 3** Zhvillimit të politikave për ofrimin e shërbimeve ju mungojnë mekanizmat efektivë koordinues në nivelin qendror
- 4** Ndërrimet e shpeshta të qeverive kanë bllokuar harmonizimin e legjislacionit

## 2022

- 1** Qeveria i ka trajtuar reformat në këtë fushë në mënyrë të pjesshme, përmes progresit në institucione individuale, në vend që të transformojë në mënyrë gjithëpërfshirëse ofrimin e shërbimeve
- 2** Zbatimi i ligjit për procedurat e përgjithshme administrative ka qenë i ngadalshëm
- 3** MPB si institucioni përgjegjës për ofrimin e shërbimeve i mungon një njësi e specializuar për të menaxhuar dhe monitoruar politikën e ofrimit të shërbimeve publike
- 4** Portali dixhital e-Kosova nuk trajton problemet me ofrimin e shërbimeve pa recetë
- 5** Cilësia dhe besueshmëria e të dhënave mbeten sfidë
- 6** Ofrimi i shërbimeve për grupet në situata të cenueshme sociale, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, mbetet joefikas



# Funksionimi i Gjyqësorit

Sipas këtij raporti Republika e Kosovës ende është në një fazë të hershme të zbatimit të standardeve evropiane të një sistemi gjyqësor që funksionon mirë. Administrimi i përgjithshëm i drejtësisë vazhdon të jetë i ngadaltë, joefikas dhe i cenueshëm ndaj ndikimeve të pa drejta. Të tjerë, në raport theksohet se kapaciteti i gjyqësorit dhe prokurorisë, duke përfshirë trajtimin e rasteve në kohën e duhur, mbetet i dobët, po ashtu sipas këtij raporti rastet e profil të lartë dhe të ndjeshme jo gjithmonë procedohen në kohën e duhur. Raporti përmend se gjatë periudhës raportuese, është arritur një progres ku janë ndërmarrë hapa për fillimin e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit për sundimin e ligjit dhe fillimin e reformës së kornizës legjislative që rregullon sistemin prokurorial duke ndryshuar Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK). Kosova përfundoi krijimin e Sistemit e Menaxhimit Informativ të Lëndëve elektronike në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë dhe vazhdoi të forcojë sistemin qendror të të dhënave penale, megjithëse sfida tjera mbeten.

Raporti po ashtu vë në dukje faktin që Qeveria ka miratuar një koncept dokument që paraqet propozimin e saj për të kryer një verifikim gjithëpërfshirës të gjyqtarëve dhe prokurorëve (Vetting). Një qasje gjithëpërfshirëse ndaj reformës në drejtësi, e cila bazohet në një qasje holistike të boshllëqeve dhe dobësive të sistemit gjyqësor, është e nevojshme për të siguruar ndikim afatgjatë. Reforma në drejtësi duhet të adresohet para së gjithash duke përmirësuar zbatimin e mjeteve ekzistuese për të mbrojtur integritetin, pavarësinë dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor, duke përfshirë edhe nëpërmjet ndryshimeve të duhura legjislative. Këto mekanizma përfshijnë, ndër të tjera, një sistem të deklarimit të pasurisë, procedura disiplinore dhe vlerësim të qëndrueshëm të performancës, në përputhje me rekomandimet e Opinionit të Komisionit të Venecias të datës 17 qershor 2022 mbi koncept dokumentin për vettingun dhe standardet përkatëse evropiane.

## 2021

- 1** Kosova është në një fazë të hershme/ka një nivel përgatitjeje për zbatimin e acquis të BE-së dhe standardet evropiane në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore
- 2** Kosova është ende në një fazë të hershme në zhvillimin e një sistemi gjyqësor që funksionon mirë. Administrimi i përgjithshëm i drejtësisë vazhdon të jetë i ngadaltë, joefikas dhe i cenueshëm ndaj ndikimeve të panevojshme politike
- 3** Në përgjithësi, niveli i profesionalizmit dhe kompetencës, veçanërisht i prokurorëve, mbetet një çështje shqetësuese, pavarësisht përpjekjeve për të rritur trajnimin në dispozicion
- 4** Kapaciteti i gjyqësorit dhe prokurorisë, duke përfshirë trajtimin e rasteve në kohën e duhur, mbetet i dobët
- 5** Kuvendi ende nuk ka emëruar dy anëtarë të mbetur, nga 13, të Këshillit Prokurorial të Kosovës (që përfaqëson Odën e Avokatëve dhe Shoqërinë Civile) si dhe një anëtar, gjithashtu nga 13, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (nga komunitetet joshumicë). Përveç kësaj, një anëtar i Këshillit Gjyqësor dha dorëheqjen më pas gjatë vitit 2021. Kuvendi duhet të sigurojë një konstituim të plotë të dy Këshillave, pa vonesë
- 6** Buxheti i ndarë për Këshillin Gjyqësor dhe atë të Prokurorisë u ul gjatë shqyrtimit afatmesëm në vitin 2020, kryesisht për shkak të ridrejtitimit të fondeve
- 7** Është bërë përparim i kufizuar në lidhje me gjyqësorin dhe prokurorinë, duke përfshirë funksionimin e gjyqësorit dhe hetimin dhe ndjekjen penale të disa rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit
- 8** Këshilli Gjyqësor i Kosovës zgjodhi kryesuesin e ri, pa marrë parasysh dispozitat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit dhe anëtarësimin në Këshill
- 9** Gjykatat dhe prokuroria kanë zgjedhur anëtarët e tyre në të dy Këshillat për të zëvendësuar anëtarët, mandati i të cilëve ka skaduar gjatë periudhës raportuese. Komuniteti ndërkombëtar, përfshirë BE-në, refuzoi të monitorojë procesin zgjedhor të zhvilluar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, për shkak të shqetësimeve për mungesën e transparencës së procesit dhe konflikteve të mundshme të interesit. Gjykatat dhe prokuroria kanë zgjedhur anëtarët e tyre në të dy Këshillat për të zëvendësuar anëtarët, mandati i të cilëve ka skaduar gjatë periudhës raportuese. Komuniteti ndërkombëtar, përfshirë BE-në, refuzoi të monitorojë procesin zgjedhor të zhvilluar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, për shkak të shqetësimeve për mungesën e transparencës së procesit dhe konflikteve të mundshme të interesit.

## 2022

- 1** Kosova është në një fazë të hershme/ka një nivel përgatitjeje për zbatimin e acquis të BE-së dhe standardet evropiane në fushën e gjyqësorit dhe të drejtave themelore
- 2** Kosova është në një fazë të hershme në zhvillimin e një sistemi gjyqësor që funksionon mirë. Administrimi i përgjithshëm i drejtësisë vazhdon të jetë i ngadaltë, joefikas dhe i cenueshëm ndaj ndikimeve të panevojshme
- 3** Në përgjithësi, niveli i profesionalizmit dhe kompetencës, veçanërisht i prokurorëve, mbetet një çështje shqetësuese, pavarësisht përpjekjeve për të rritur trajnimin në dispozicion
- 4** Kapaciteti i gjyqësorit dhe prokurorisë, duke përfshirë trajtimin e rasteve në kohën e duhur, mbetet i dobët
- 5** Nga Kuvendi i Kosovës ka një vonesë të vazhdueshme në emërimin e anëtarëve të Këshillave. Kuvendi duhet të sigurojë rregullisht konstituimin e plotë të të dy Këshillave, pa asnjë vonesë
- 6** Buxheti i ndarë për të dy Këshillat është ulur për vitin 2022, krahasuar me vitin 2021. Kjo ka kufizuar edhe më tej numrin e pozitave të stafit mbështetës profesional për gjykata dhe prokurori.
- 7** Rastet e profil të lartë dhe të ndjeshme jo gjithmonë procedohen në kohën e duhur
- 8** Është bërë përparim i kufizuar, duke përfshirë disa përparime në funksionimin e gjyqësorit në hetimin dhe ndjekjen penale në disa raste të krimit të organizuar dhe korrupsionit të nivelit të lartë

Rritja e përpjekjeve për të reduktuar numrin e rasteve të mbetura bazuar në një plan të rishikuar të mbështetur nga një strategji dixhitalizimi; për këtë qëllim, të sigurojë përdorimin sistematik të Sistemit të Informacionit të Menaxhimit të Çështjeve nga gjyqtarët, prokurorët dhe stafi mbështetës për caktimin automatik të çështjeve, dhe të promovojë dhe financojë më tej përdorimin e mjeteve alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, siç është ndërmjetësimi, i mbështetur nga një monitorim dhe vlerësim sistemi për të ndjekur ndikimin e shërbimeve të ndërmjetësimit. Sigurimi i të dhënave statistikore të besueshme, në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ).

## Rekomandimet

Përmirësimi i integritetit dhe profesionalizmit në sistemin gjyqësor duke përmirësuar mjetet ekzistuese (sistemi i deklarimit të pasurisë, procedimet disiplinore, vlerësimet e performancës dhe kontrollet e integritetit të kufizuara në institucionet e larta gjyqësore), duke përfshirë ndryshimet e duhura legjislative. Sigurohuni që çdo reformë në drejtësi të kryhet në përputhje me rekomandimet përkatëse të Komisionit të Venecias dhe standardet evropiane

Të vazhdojë zbatimin efektiv të strategjisë dhe planit të veprimit për sundimin e ligjit pa vonesë, me anë të një procesi të rregullt dhe të strukturuar që përfshin koordinimin e duhur ndër-institucional



# Lufta kundër korrupsionit

Tek kapitulli i luftës kundër korrupsionit, raporti thekson se Kosova është në një fazë të hershme, ka një nivel përgatitje. Gjatë periudhës raportuese Kuvendi miratoi Kodin e ri të Procedurës Penale, Ligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Ligji i ri për Deklarimin e Pasurisë dhe Legjislacioni për financimin e partive politike, megjithatë në raport thuhet se ekziston nevoja për të përmirësuar zbatimin e kuadrit të përgjithshëm ligjor.

Tutje në Raport thuhet se përkundër faktit se Departamenti për Korrupsion dhe Krim Financiar është themeluar gjatë periudhës raportuese, Prokuroria Speciale ka ngritur pak aktakuza në rastet e profilit të lartë. Sipas raport të progresit, nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të pasur hetime më proaktive, vendime gjyqësore përfundimtare dhe konfiskim përfundimtar të aseteve. Sipas raportit problemi kryesor mbetet mungesa e zbatimit të legjislacionin ekzistues.

Në përgjithësi sipas këtij raporti, korrupsioni është i përhapur dhe mbetet një çështje shqetësuese serioze dhe se pavarësisht përpjekjeve të bëra, ekziston nevoja për vullnet të fortë politik për të vazhduar trajtimin efektiv të rreziqeve të korrupsionit sistemik dhe një përgjigje të fuqishme të drejtësisë penale ndaj korrupsionit të nivelit të lartë.

## 2021

- 1** Lufta kundër korrupsionit në Kosovë është në një fazë të hershme/ka një nivel përgatitjeje
- 2** Në përgjithësi, korrupsioni është i përhapur dhe mbetet një çështje shqetësuese serioze
- 3** Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të pasur hetime më proaktive, vendime gjyqësore përfundimtare dhe konfiskim përfundimtar të aseteve
- 4** Kuadri ligjor për konfiskimin vazhdon të jetë kryesisht i pazbatuar dhe vlera e aseteve të konfiskuara përfundimisht mbetet e ulët
- 5** Shumica e rekomandimeve të raportit të vitit 2020 mbeten të vlefshme, me problem kryesor ende moszbatimin e legjislacionit ekzistues
- 6** Përparim i kufizuar, duke përfshirë hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të nivelit të lartë në histori dhe në lidhje me një performancë të përmirësuar dhe ngritja e Prokurorisë Speciale

### Rekomandimet:

Në vitin e ardhshëm Kosova duhet të:

- Të forcojë më tej kapacitetet e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në aspektin e stafit dhe ekspertizës, për t'u siguruar që ajo mund të kryejë në mënyrë efektive mandatin e saj
- Të forcojë më tej efikasitetin e regjimit të konfiskimit duke promovuar përdorimin sistematik të konfiskimit të zgjatur dhe atë "të rregullt" nga ndjekja penale dhe policia
- Të rrisë nivelin e specializimit dhe ekspertizës në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë
- Të krijojë një fond të konfiskimit

## 2022

- 1** Kosova është në një fazë të hershme/ka njëfarë niveli të përgatitjes
- 2** Në përgjithësi, korrupsioni është i përhapur dhe mbetet një çështje shqetësuese serioze
- 3** Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të pasur hetime më proaktive, vendime gjyqësore përfundimtare dhe konfiskim përfundimtar të aseteve
- 4** Kuadri ligjor për konfiskimin vazhdon të jetë kryesisht i pazbatuar dhe vlera e aseteve të konfiskuara përfundimisht mbetet e ulët
- 5** Problemi kryesor mbetet mungesa e zbatimit të legjislacionit ekzistues
- 6** Përkundër faktit se Departamenti për Korrupsion dhe Krim Financiar është themeluar gjatë periudhës raportuese, Prokuroria Speciale ka ngritur pak aktakuza në raste të profilit të lartë

Të forcojë më tej bashkëpunimin e institucioneve ligj zbatuese dhe prokurorisë dhe të inkurajojë bashkëpunimin multidisiplinar dhe të vendosë objektiva për të siguruar hetime proaktive dhe për të luftuar në mënyrë efektive korrupsionin e nivelit të lartë

Zbatim efektiv të legjislacionit të ri për financimin e partive politike



# Deklarimi i Rremë i Pasurisë, Konflikti i Interesit, Konfiskimi i Pasurisë, Auditimi i Financave të Partive Politike

Sa i përket deklaramit të pasurisë thuhet se në Agjencinë kundër korrupsionit, mbi 200 raste janë duke u hetuar për shkak të deklaramit të rremë të pasurisë dhe gjithashtu për mosdeklarim të pasurisë, prej tyre 190 raste iu referuan prokurorisë dhe policisë për hetime të mëtejshme (50 me dyshime për deklarim të rremë të bartur nga viti 2020 dhe 190 për mosdeklarim të pasurisë).

Raporti vë në dukje edhe mangësitë në sistemin e deklaramit dhe vlerësimit të origjinës së pasurisë që i përket zyrtarëve të lartë publik.

Sa i përket konfliktit të interesit në raport thuhet se kuadri ligjor për parandalimin e konfliktit të interesit nuk është duke u zbatuar plotësisht. Një numër zyrtarësh të lartë publikë ende zënë dy ose më shumë poste, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me ligjin. Në lidhje me auditimin e rregullt vjetor të partive politike kjo çështje ka ngjitur sipas raportit të progresit pasi mungon auditimi i rregullt nga Kuvendi dhe aplikimi selektiv i sanksioneve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjë që rezultojn në një mbikëqyrje jo të plotë të financimit të fushatës.

## 2021

- 1 Agjencia Kundër Korrupsionit ka 968 zyrtarë në procedurë të kontrollit të plotë të pasurisë, prej të cilëve 77 janë referuar në prokurori dhe polici për hetime të mëtejshme (26 për dyshime për deklarim të rremë dhe 51 për mosdeklarim të pasurisë). Në vitin 2020 ka pasur 23 vendime gjyqësore (11 në 2019)
- 2 Vazhdojnë mangësitë në sistemin e deklaramit dhe vlerësimit të origjinës së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë
- 3 Pavarësisht nga një kornizë ligjore mjaft e avancuar, konfiskimi i aseteve kriminale vazhdon të anashkalohet në masë të madhe, me fokus dhe burime të pamjaftueshme për të. Ligji për Kompetencat e Zgjeruara të Konfiskimit është në fuqi që nga viti 2019 por nuk po zbatohet në mënyrë konsistente
- 4 Konfiskimi si mjet për të synuar interesat ekonomike të organizatave kriminale mbetet i pashfrytëzuar nga prokurorët, të cilët mbeten hallka më e dobët në këtë drejtim. Në përgjithësi, gatishmëria për të konfiskuar pasuritë mbetet e ulët
- 5 Financimi për partitë politike dhe financimi i fushatave nuk ka transparencë dhe kuadri rregullator mbetet i pamjaftueshëm
- 6 Procesi i auditimit të partive politike ka dështuar prej dy vitesh për shkak të buxhetit të ulët të ndarë për punësimin e auditorëve

## 2022

1

Mbi 200 raste janë duke u hetuar për shkak të deklaramit të rremë të pasurisë dhe gjithashtu për mosdeklarim të pasurisë. 190 raste iu referuan prokurorisë dhe policisë për hetime të mëtejshme (50 me dyshime për deklarim të rremë të bartur nga viti 2020 dhe 190 për mosdeklarim të pasurisë)

4

Konfiskimi si mjet për të synuar interesat ekonomike të organizatave kriminale mbetet i pashfrytëzuar nga prokurorët, të cilët mbeten hallka më e dobët në këtë drejtim. Në përgjithësi, gatishmëria për të konfiskuar pasuritë mbetet e ulët

2

Vazhdojnë mangësitë në sistemin e deklaramit dhe vlerësimit të origjinës së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë

5

Mungon auditimi i rregullt nga Kuvendi dhe aplikimi selektiv i sanksioneve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjë që rezultojn në një mbikëqyrje jo të plotë të financimit të fushatës

7

Kuadri ligjor për parandalimin e konfliktit të interesit është në fuqi që nga viti 2018, por ende duhet të zbatohet plotësisht. Një numër zyrtarësh të lartë publikë ende zënë dy ose më shumë poste, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me ligjin.

3

Pavarësisht nga një kornizë ligjore mjaft e avancuar, konfiskimi i aseteve kriminale mbetet i ulët. Ligji i vitit 2019 për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit është në fuqi, por nuk po zbatohet në mënyrë konsistente

6

Shumica e subjekteve politike nuk kanë vendosur rregulla të kontrollit të brendshëm financiar. Burime të shumta të të ardhurave dhe shpenzimeve mbeten të paraportuara. Procesi i auditimit ka dështuar prej dy vitesh për shkak të buxhetit të ulët të ndarë për punësimin e auditorëve

## Rekomandimet

Kapacitetet e Agjencisë, për sa i përket numrit të stafit, burimeve të TI-së dhe trajnimeve, duhet të rriten. Një sistem deklarimi elektronik po hyn në fuqi për të thjeshtuar procesin e deklaramit dhe dorëzimit si dhe rritja e transparencës dhe saktësisë në monitorim dhe verifikim

Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave me policinë, administratën tatimore, Njësinë e Inteligjencës Financiare, regjistrin kadastral dhe autoritetet komunale duhet të forcohen

Të forcojë më tej kapacitetet e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në aspektin e stafit dhe ekspertizës, për t'u siguruar që ajo mund të kryejë në mënyrë efektive mandatin e saj

Konfiskimi i aseteve kriminale duhet të bëhet një prioritet strategjik në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit të nivelit të lartë në vend.